



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

[Datë 20.12.2021]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “PC STORE” shpk
Adresa: Rruga e Dibrës, Vila nr.153, Kati i Parë, Tiranë

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar.**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-11993-11-17-2021**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Objekti i kontratës: **“Blerje Pajisje Dixhitale, Audiovizuale dhe Aksesore”**; *Kohëzgjatja e kontratës:* Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga lidhja e kontratës.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 167 datë 22 Nëntor 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik ”INFORMATION BUSINESS SYSTEMS -IBS” shpk, NIPT J61820057C

Vlera e ofertës pa tvsh – 3.999.000 (tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë

Vlera e ofertës me tvsh- 4.798.800 (katër milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë.

2. Operatori ekonomik “PC STORE” shpk, NIPT L01606034A

Vlera e ofertës pa tvsh – 4,092,670 (katër milion e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë

Vlera e ofertës me tvsh- 4,911,204 (katër milion e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind e katër) lekë.

3. Operatori ekonomik “FREDI ELECTRONIC” shpk, NIPT K91803020F

Vlera e ofertës pa tvsh – 4,124,000 (katër milion e njëqind e njëzetë e katër mijë) lekë

Vlera e ofertës me tvsh- 4,948,800 (katër milion e nëntëqind e dyzetë e tetë mijë e tetëqind) lekë.

Nga pjesëmarrësit është s’kualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik "INFORMATION BUSINESS SYSTEMS -IBS" shpk, NIPT J61820057C

Për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik "IBS" nuk plotëson nenin 82 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, për "Prokurimin publik", dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", pasi në formularin përmbledhës të vetedeklarimit të paraqitur nga ky OE, nuk është plotësuar e plotë Shtojca 8, **Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit:**

- Paragrafi 3, nuk ka deklaruar/ plotësuar të dhënat e ortakut të shoqërisë dhe dokumentacionin përkatës/ llojin e dokumentit dhe Autoritetin nga i cili lëshohet ky dokument.
- Paragrafi 4, nuk ka deklaruar/ plotësuar pjesën ku kërkohet dokument që vërteton që subjekti nuk është dënuar nga Gjykata me vendim të formës së prerë në lidhje me veprimtarin profesionale, llojin e dokumentit dhe Autoritetin nga i cili lëshohet ky dokument
- Paragrafi i fundit i Pjesës 2 nuk ka deklaruar/ plotësuar pikën në të cilën kërkohet dokumenti që nuk është përjashtuar nga prokurimet publike që lëshohet nga APP.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin publik" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 82 pika 2, konkludon njëzëri se, oferta e Operatorit ekonomik "**INFORMATION BUSINESS SYSTEMS -IBS**" shpk, nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur **ofertë të pavlefshme**.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik "**PC STORE**" shpk, me adresë Rruga e Dibrës, Vila nr.153, Kati i Parë, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 4,092,670 (katër milion e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh dhe 4,911,204 (katër milion e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind e katër) lekë me tvsh, është identifikuar si Oferta e Suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".